

VENDIM
Nr. 685, datë 11.9.2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 38, DATË 21.1.2026, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT TË
DREJTPËRDREJTË NË TND EDHE PËR KANDIDATË TË TJERË JASHTË
SHËRBIMIT CIVIL DHE PËR PËRDORIMIN E PROCEDURËS SË PRANIMIT TË
DREJTPËRDREJTË NË TND, PËR VITIN 2026”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 27, pika 5, e 29, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe në vijim të pikave 2, 3 e 4, të kreut V, të vendimit nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3, të vendimit nr. 38, datë 21.1.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil dhe për përdorimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND, për vitin 2026”, togfjalëshi “... është 11 (njëmbëdhjetë) ...” zëvendësohet me “... është 15 (pesëmbëdhjetë) ...”.

2. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama